VENDIM
Nr.1708, datë 29.12.2008

PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE PËR RUAJTJEN IN-SITU TË RACAVE AUTOKTONE TË BAGËTIVE TË IMËTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 60 të ligjit nr.9426, datë 6.10.2005 "Për mbarështimin e blegtorisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 10 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Programet për ruajtjen *In-situ* të racave autoktone të bagëtive të imëta zbatohen për ato raca dhe/ose ekotipe, të cilat shpallen "Raca/ekotipe në gjendje kritike për t'u zhdukur", sipas përcaktimit të aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngritjen, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të komisionit të vlerësimit për gjendjen dhe nivelin e rrezikut të zhdukjes në racat/ekotipet autoktone të bagëtive të imëta. Veprimtaria e këtj komisioni përcaktohet me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Ngritjen, në drejtorinë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, të komisionit të identifikimit të racave/ekotipeve të bagëtive të imëta në rrezik për t'u zhdukur, i cili të drejtohet nga inspektori i zooteknisë.

4. Një ndër hallkat kryesore të programeve për ruajtjen *In-situ* të racave dhe/ose ekotipeve autoktone të bagëtive të imëta, të shpallura "Raca/ekotipe në gjendje kritike për t'u zhdukur", është zbatimi i pagesës, një herë në vit, i fermerëve, që janë pronarë të tufave, që do të përfshihen në këto programe.

5. Masa e pagesës të jetë: 2 000 (dy mijë) lekë për riprodhues femër dhe 3 000 (tre mijë) lekë për riprodhues mashkull, të matrikulluar. Kjo pagesë zbatohet jo më pak se 4 vjet për çdo racë/ekotip, të shpallur "Racë/ekotip në gjendje kritike për t'u zhdukur". Pagesa ndërpritet me shpalljen e vendimit për kapërcimin e gjendjes kritike për t'u zhdukur.

Për realizimin e kësaj pagese, në Buxhetin e Shtetit të parashikohen, çdo vit, 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

NIVELI I RREZIKSHMËRISË PËR T'U ZHDUKUR
(numri i riprodhuesve femra në popullatë)

Niveli i rrezikshmërisë	**Gjedh**	**Kuaj**	**Dhentë e dhitë**	**Derra**	**Lepuj**	**Shpend**
1.Shumë kritike	<150	<300	<300	<100	<100	<100
2.Kritike	250	500	500	200	250	250
3.Të rrezikuar	450	900	900	300	500	500

4.Në prag të rrezikut	750	1500	1500	500	1000	1000
5.Të parrezikuar	1500	3000	3000	1000	2500	2500